



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 406 Prot.

Tiranë, më 12/5/2015

REKOMANDIM

Nr. 25, datë 12/5/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, në kuadër të inspektimeve të ushtruara në disa banka të nivelit të dytë që operojnë në Republikën e Shqipërisë dhe respektimit të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me qëllim disiplinimin dhe sensibilizimin e sektorit bankar,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka realizuar hetim administrativ pranë disa kontrolluesve "Banka të Nivelit të Dytë", me objekt: *Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.*

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e sektorit bankar në kuadër të impaktit që ka në jetën e çdo qytetari dhe rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave të tyre personale dhe privatësisë së tyre, me qëllim respektimin e detyrimeve ligjore përkatëse.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm, procesin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetit në sektorin bankar. Në këtë kuadër, janë evidentuar disa nga problematikat e hasura më shpesh në këtë fushë. Problematikat i janë referuar praktikës së deritanishme në zbatim të ushtrimit të funksionit monitorues dhe mbikëqyrës së Zyrës së Komisionerit në zbatim të ligjit, mangësive të konstatuara gjatë kontroleve administrative të ushtruara në kontrollues bankar dhe duhen patur parasysh nga kontrolluesit gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Çdo Bankë e Nivelit të Dytë në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, është kontrollues që e ushtron veprimtarinë në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "*Për Bankën e Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 "*Për Bankat në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar si edhe në të gjithë aktet nënligjore që përbëjnë kuadrin rregullativ në fushën bankare.

"Bankat e Nivelit të Dytë" (në cilësinë e kontrolluesit) ofrojnë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh bankare për individë dhe biznese, të tilla si, llogari rrydhëse, depozita me afat, financime dhe kredi, internet banking, karta krediti, transfertat bankare etj. Gjatë kësaj marrëdhënie të krijuar kontrolluesit mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale të individëve (klientë), subjekte të të

dhënave personale. Në kuadër të veprimtarisë së tyre, kontrolluesit mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale kryesisht për kategoritë e subjekteve të të dhënave, *klientë, punonjës dhe aksionerë.*

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9887, dt. 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, Zyra e Komisionerit gjatë ushtrimit të hetimeve administrative në disa banka ka konstatuar se:

- ✚ Kontrolluesit kanë bërë pjesë të kontratave të shërbimit për produkte të ndryshme, pëlqimin e klientit, për të përdorur të dhënat e tij personale, për qëllime marketingu dhe promovimi për produktet bankare, pa e informuar subjektin e të dhënave, për këtë qëllim të dytë përpunimi të të dhënave. Pëlqimi nuk është i shprehur në mënyrë opsionale, me nënshkrim veçmas dhe në një formë specifike, sipas kriterëve të nenit 3 dhe 5/1/b të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar;
- ✚ Kontrolluesit priren të mbledhin më tepër kategori të dhënash personale se ato që nevojiten realisht për realizimin e qëllimit, në kundërshtim me “parimin e mjaftueshmërisë”, sanksionuar në nenin 5/1/c të ligjit;
- ✚ Nuk është respektuar neni 18 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, sa i përket:
 - Informimit të subjekteve të të dhënave personale (klientë), në formë të shkruar, mbi fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. Në përmbajtjen e kontratave për ofrim produktesh të ndryshme dhe format e aplikimit, që përdor kontrolluesi, nuk rezulton informimi i subjekteve të të dhënave sa më sipër;
 - Publikimit në faqen e internetit, të rubrikës “politika privatësie”. Në disa raste kjo rubrikë nuk ekziston në faqe por edhe në rastet kur parashikohet, janë evidentuar mangësi në përmbajtjen e saj pasi nuk ka të parashikuara rregulla, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe politika ku të përfshihen kushtet dhe kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale.
- ✚ Në marrëdhëniet/marrëveshjet që Banka (kontrolluesi) krijon me të tretë (në cilësinë e përpunuesit),që kanë si objektiv përpunimin e të dhënave personale (qoftë edhe akses në të dhëna),nuk janë sanksionuar rregulla mbi sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave, në kundërshtim me nenin 20 të ligjit;
- ✚ Formulari i njoftimit nuk është plotësuar ose në rastet kur është plotësuar, nuk është i përditësuar në një ose disa rubrika, në kundërshtim me nenet 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887,datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

Sa më sipër, sa i përket të drejtave të subjekteve të të dhënave, Zyra e Komisionerit vlerëson se janë shumë të rëndësishme pasi i japin mundësinë klientit që të mbrojë të dhënat e tij personale. Në kuadër të zbatimit të nenit 5/1/b të ligjit, përfshirja e pëlqimit për qëllime marketingu në formatet e kontratave të ndryshme bankare nuk reflekton qëllimin e ligjit, pasi nuk i jep mundësinë klientit për të kundërshtuar dhënien e pëlqimit për qëllime marketingu. Nëpërmjet kontratës kërkohet të ndërtohet një marrëdhënie kontraktore dhe nuk duhet që klienti të pranojë automatikisht dhe detyrimisht fushatat e marketingut. Pra, klientit duhet t'i jepet mundësia që të kundërshtojë përpunimin e të dhënave për qëllime marketingu, pa u kushtëzuar nga nënshkrimi i kontratës.

Për sa i përket zbatimit të nenit 18 të ligjit, Zyra e Komisionerit, vlerëson se informimi i klientit është një detyrim që konsiston në mbarëvajtjen dhe transparencën e marrëdhënies midis klientit dhe kontrolluesit. Nëpërmjet informimit, klienti është në gjendje që të kuptojë se çfarë ndodh me të dhënat e tij personale, ku mbahen dhe në ç'formë, për sa kohë mbahen etj, me qëllim që të jetë i ndërgjegjshëm mbi procedurat e përpunimit, duke i dhënë mundësinë për të parandaluar edhe shkelje të mundshme ndaj të dhënave të tij. Saktësimi i qëllimit të përpunimit është i rëndësishëm për shmangien edhe të abuzimeve të mundshme pasi krijohen hapësira që të dhënat të përpunohen edhe për qëllime të tjera jashtë qëllimit fillestar.

Në kuadër të zbatimit të nenit 20 të ligjit, Zyra e Komisionerit vlerëson që në marrëdhëniet/marrëveshjet që bankat krijojnë me të tretë (në cilësinë e përpunuesit), që kanë si objektiv përpunimin e të dhënave personale (qoftë edhe akses në të dhëna), të sanksionohen rregulla mbi sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave dhe të merren parasysh aktet nënligjore të Zyrës së Komisionerit në këtë drejtim. Plotësimi i këtij detyrimi është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon përhapjen e tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa i përket detyrimit për njoftim dhe në vazhdimësi përditësimit të tij (neni 21, 22 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*") Zyra e Komisionerit vlerëson se është një nga detyrimet bazë që ka çdo kontrollues dhe si i tillë ka një pozicion të rëndësishëm në raport me detyrimet e tjera që parashikon ligji. Kjo, për faktin që duhet të plotësohet përpara se kontrolluesi të fillojë përpunimin e të dhënave personale, praktikisht përpara se një subjekt privat ose publik të fitojë statusin si "Kontrollues" (i cili lidhet detyrimisht me përpunimin e të dhënave personale). Detyrimi për njoftimin (dhe për përditësimin e tij) nuk mund të konsiderohet i përfunduar dhe i pandryshueshëm në kohë. Ai lind dhe ekziston në çdo rast kur ndryshon një nga elementët e formularit të njoftimit.

Sa më sipër;

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura dhe konstatimeve të realizuara gjatë hetimeve administrative në kontrolluesit që ushtrojnë veprimtari në sektorin bankar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 5 pika 1/b, nenit 6/1/a dhe nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të tregohet kujdes që në kontratat e shërbimit për produktet bankare, të informohen subjektet e të dhënave për qëllimin e përpunimit të të dhënave në kuadër të marketingut dhe promocionit të produkteve bankare duke i ofruar mundësinë që pëlqimi në këtë rast të jetë opsional dhe i ndarë nga pëlqimi për nënshkrimin e kontratës. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtën që të revokojë pëlqimin në çdo moment që e konsideron të arsyeshëm. Kjo përfshin edhe dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të tjera jashtë qëllimit fillestar të nënshkrimit të kontratës.
2. Në zbatim të nenit 5 pika 1/c, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të dhënat personale që përpunohen të jenë të mjaftueshme, në përputhje me qëllimin e përpunimit dhe jo në tejkallim të tij.
3. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të tregohet kujdes që:

- Në çdo format që sanksionon marrëdhënien e kontrolluesit me subjektet e të dhënave personale (klientin, punonjësin) të parashikohet një dispozitë për informimin e tyre mbi fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave;
 - Në faqen e internetit të kontrolluesit, të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë”, dhe të përditësohen të dhënat, me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
4. Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, në marrëdhëniet/marrëveshjet që Banka krijon me të tretë (në cilësinë e përpunuesit), që kanë si objektiv përpunimin e të dhënave personale (qoftë edhe akses në të dhëna), të tregohet kujdes në sanksionimin e rregullave mbi sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave.
 5. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të plotësohet detyrimi për njoftim dhe të tregohet kujdes në vijimësi, në përditësimin e “Formularit të Njoftimit”, pranë Zyrës së Komisionerit.
 6. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

BESNIK DERVISHI

KOMISIONERI

